FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 45

Tiranë – E martë, 23 mars 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 15/2021, datë 8.2.2021	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014, "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar.....	5111
Ligj nr. 21/2021, datë 22.2.2021	Për një ndryshim në ligjin nr. 10 081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.....	5114
Vendim i Kuvendit nr. 30/2021, datë 16.3.2021	Për rrëzimin e dekretit nr. 11 981, datë 26.2.2021, "Për kthimin e ligjit nr. 15/2021, 'Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014, 'Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar".....	5116
Dekret i Presidentit nr. 12023, datë 17.3.2021	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	5116
Dekret i Presidentit nr. 12025, datë 18.3.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	5116
Dekret i Presidentit nr. 12030, datë 19.3.2021	Për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.....	5117
Dekret i Presidentit nr. 12031, datë 19.3.2021	Për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.....	5117
Dekret i Presidentit nr. 12032, datë 19.3.2021	Për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.....	5118
Dekret i Presidentit nr. 12033, datë 19.3.2021	Për emërimin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë.....	5118

Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 9, datë 22.3.2021	Për miratimin e tekstit të marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar *"Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret" A.Ş.* për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 *(Vero Cell) Coronavac*, të krijuar nga *Sinovac Life Science Co Ltd.* dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës.....	5118
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 117, datë 5.3.2021	Për miratimin e formës dhe të përmbajtjes së vulës, dokumentit të identifikimit dhe të plumbit të sekuestrimit përmbarimor të përmbaruesit gjyqësor privat.....	5119
Urdhër i ministrit të Drejtësisë nr. 118, datë 5.3.2021	Për miratimin e rregullores së Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbaruesve.....	5122
Urdhër i drejtorit të Përgjithshëm të Arkivave nr. 239, datë 19.3.2021	Për delegim kompetencash.....	5130
Njoftim i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme nr. 3396, datë 19.3.2021	Mbi hyrjen në fuqi të një protokolli ndryshues.....	5130
	Vendim *(i shkurtuar)* për shpalljen të vdekur të shtetasit Edmond Dinaku.....	5130
	Vendim *(i shkurtuar)* për heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Herëmont Piho.....	5130
	Vendim *(i shkurtuar)* për heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasin Julian Topanxha.....	5131
	Kërkesë për shpalljen të vdekur shtetasit Romeo Beluli.....	5131

LIGJ
Nr. 15/2021

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 59/2014, "PËR KARRIERËN USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 59/2014, "Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në pikën 1 të nenit 9 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Nënndarja "i" e shkronjës "a" ndryshohet si më poshtë:

"i. kontrata lidhet për një afat jo më pak se 3 (tre) vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës nuk duhet të kalojë moshën maksimale të përcaktuar në nenet 14, pika 1, dhe 14/1 të këtij ligji;".

2. Nënndarja "i" e shkronjës "b" ndryshohet si më poshtë:

"i. kontrata lidhet për një afat jo më pak se 3 (tre) vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës nuk duhet të kalojë moshën maksimale të përcaktuar në nenet 14, pika 1, dhe 14/1 të këtij ligji;".

3. Nënndarjet "i" dhe "ii" të shkronjës "c" ndryshohen si më poshtë:

"i. kontrata lidhet me fillimin e studimeve brenda dhe jashtë vendit. Në kontratë përfshihen koha e arsimimit dhe 6 (gjashtë) vjet periudhë shërbimi nga data e emërimit të parë si oficer në Forcat e Armatosura. Kohëzgjatja e ripërtëritjes së kontratës nuk duhet të kalojë moshën maksimale të përcaktuar në nenet 14, pika 1, dhe 14/1 të këtij ligji;

ii. në emër të Forcave të Armatosura, për studentët ushtarakë nënshkruan komandanti i strukturës mbështetëse për çështje të arsimimit ushtarak, ndërsa për oficerët nënshkruan drejtuesi i njësisë së menaxhimit të personelit në Ministrinë e Mbrojtjes.".

Neni 2

Në nenin 12 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) shkronja "ç" e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"ç) Për studentët:

Titulli	Lloji i gradës
Student ushtarak	Ushtar I";

b) pas pikës 3 shtohet pika 4 me këtë përmbajtje:

"4. Ushtarët dhe nënoficerët, që konkurrojnë për shkolla të larta ushtarake brenda vendit, ruajnë gradën që mbajnë në momentin e pranimit në shkollat e larta ushtarake deri në përfundim të studimeve.".

Neni 3

Në nenin 13 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja "ç" e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"ç) Ushtar IV Detar IV 2 vjet".

2. Pika 2 shfuqizohet.

Neni 4

Shkronjat "g" e "gj" të pikës 1 të nenit 14 ndryshohen si më poshtë:

"g) Nëntoger	Nënlejtënant 33 vjeç;
gj) Toger	Lejtënant 38 vjeç".

Neni 5

Pas nenit 14 shtohen nenet 14/1 e 14/2 me këtë përmbajtje:

"Neni 14/1
Mosha maksimale e qëndrimit në shërbimin aktiv për specialitetet

1. Mosha maksimale e qëndrimit në shërbim aktiv për specialitetet është:

Forca tokësore/ajrore	Forca detare	Mosha në shërbim aktiv
a) Ushtar IV	Detar IV	42 vjeç;
b) Nëntetar	Nëntetar	45 vjeç
c) Tetar	Tetar	50 vjeç;
ç) Rreshter	Rreshte	57 vjeç;
d) Kapter	Kapter	58 vjeç;
dh)Nëntoger	Nënlejtënant	41 vjeç
e)Toger	Lejtënant	45 vjeç;
ë)Kapiten	Kapiten lejtënant	51 vjeç;
f)Major	Kapiten i rangut të tretë	60 vjeç;
g)Nënkolonel	Kapiten i rangut të dytë	61 vjeç.

Neni 14/2
Mosha minimale e konkurrimit për marrjen e gradës

Mosha minimale për konkurrim për marrjen e gradave të larta dhe gradës "Gjeneral brigade/ Kundëradmiral" është si më poshtë:

Forca tokësore/ajrore	Forca detare	Mosha në shërbim aktiv
a) Kapiten	Kapiten lejtënant	34 vjeç;
b) Major	Kapiten i rangut të tretë	40 vjeç;
c) Nënkolonel	Kapiten i rangut të dytë	45 vjeç;
ç) Kolonel	Kapiten i rangut të parë	50 vjeç.".

Neni 6

Në pikën 1 të nenit 15 fjala "parauniversitar" zëvendësohet me fjalët "9-vjeçar".

Neni 7

Në pikën 1 të nenit 16, pas fjalëve "ka kryer" shtohen fjalët "minimalisht arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit dhe".

Neni 8

Në pikën 2 të nenit 18 fjala "dy" zëvendësohet me fjalën "tre".

Neni 9

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

"Neni 20
Arsimimi dhe kualifikimi për përparim në gradë

Ushtarakët e Forcave të Armatosura për të fituar gradën e radhës duhet të plotësojnë kriteret e arsimimit e të kualifikimit, të përcaktuara në politikën e arsimimit të Forcave të Armatosura, të miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes e me propozim të shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.".

Neni 10

Në nenin 21 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1. Përparimi në gradë për oficerët deri në gradën "nënkolonel/kapiten i rangut të dytë", nënoficerët deri në gradën "kapter" dhe ushtarët deri në gradën "ushtar IV", që kryejnë detyra organike në specialitete në Forcat e Armatosura, bëhet sipas kritereve të përcaktuara në nenet 13 e 14/1 të këtij ligji dhe në përputhje me nevojat organike të Forcave të Armatosura.".

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

"1/1. Specialitetet, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Mbrojtjes.".

Neni 11

Në shkronjën "b" të pikës 3 të nenit 22, pas nënndarjes "iii" shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

"Në rast mungese organike të oficerëve me gradën madhore "gjeneralmajor/nënadmiral", ata zëvendësohen me oficerë me gradën madhore "gjeneral brigade/kundëradmiral.".

Neni 12

Në nenin 24 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Fjalia e dytë e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"Në mbarim të kësaj periudhe, ushtaraku emërohet në përputhje me gradën që mban, me përjashtim të rastit kur plotëson kushtet për daljen në lirim sipas shkronjës "b" të nenit 26 të këtij ligji.".

2. Shkronja "c" e pikës 2 ndryshohet si më poshtë:

"c) me kërkesën e ushtarakut për të shoqëruar bashkëshortin/bashkëshorten, që emërohet jashtë shtetit në funksione zyrtare ose që dërgohet në trajnime/kualifikime afatgjata mbi 9 (nëntë) muaj jashtë vendit. Në këtë rast, pezullimi zgjat sa periudha e emërimit ose trajnimit/kualifikimit, por jo më shumë se 4 (katër) vjet.".

Neni 13

Në nenin 25 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Shkronja "b" e pikës 1 ndryshohet si më poshtë:

"b) pavarësisht numrit të aplikimeve për marrjen e gradës së radhës, ka plotësuar moshën maksimale të qëndrimit në shërbim, përcaktuar në nenin 14 të këtij ligji.".

2.Shkronja "c" e pikës 1 shfuqizohet.

Neni 14

Në pikën 1 të nenit 26 shkronja "b" ndryshohet si më poshtë:

"b) vuan dënim me burgim me vendim gjyqësor të formës së prerë ose dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi me dashje.".

Neni 15

Në nenin 32 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 1 ndryshohet si më poshtë:

"1.Ushtaraku mund të emërohet në një funksion me një gradë më të ulët, duke mbajtur gradën që ka, por jo për më shumë se 1 (një) vit. Emërimi në një funksion më të ulët sipas kësaj pike nuk mund të kryhet pa kaluar të paktën 3 (tre) vjet nga emërimi i mëparshëm në një funksion me një gradë më të ulët.".

2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 si më poshtë:

"1/1. Në rast pëlqimi me shkrim nga vetë ushtaraku, emërimi në një funksion me një gradë më të ulët mund të bëhet më shumë se afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.".

Neni 16
Dispozita kalimtare

1. Brenda 1 (një) viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të gjithë ushtarakët e larguar nga shërbimi aktiv dhe për të cilët nuk ka urdhra përkatës të nxjerrjes në lirim/rezervë, lirohen nga shërbimi aktiv me urdhër të organit kompetent, me efekt nga data e largimit të tyre faktik, të verifikuar me dokumentacion zyrtar në dispozicion të strukturave të Forcave të Armatosura dhe Ministrisë së Mbrojtjes.

2. Të gjithë nëntetarëve, nëntogerëve e togerëve, të cilët kanë konkurruar 2 (dy) herë dhe nuk kanë marrë gradën e radhës, u lind e drejta të aplikojnë edhe një herë tjetër në rast se nuk kanë kaluar moshën maksimale të qëndrimit në shërbimin aktiv, sipas neneve 14 e 14/1 të këtij ligji.

Neni 17
Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e aktit nënligjor, në zbatim të pikës 2 të nenit 10, brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 18
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 8.2.2021.

LIGJ
Nr. 21/2021

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10 081, DATË 23.2.2009, "PËR LICENCAT, AUTORIZIMET DHE LEJET NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Shtojca bashkëlidhur ligjit nr. 10 081, datë 23.2.2009, "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, zëvendësohet me shtojcën që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 22.2.2021.

1. SHTOJCA 1

Nr.	Nr. i fushës/kategorisë	Lloji i kategorisë	Fusha/kategoritë e veprimtarive dhe/ose të të mirave publike e të përdorimeve të tyre
	Fusha I		**Siguria kombëtare, rendi publik dhe mbrojtja civile**
1	1.	Licencë	Prodhimi dhe/ose tregtimi i mallrave (armë, municione, lëndë, pajisje, teknologji etj.) ushtarake dhe/ose me përdorim të dyfishtë
2	2.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të mbrojtjes civile
3	3.	Licencë	Shërbimi privat i sigurisë fizike
	Fusha II		**Ushqimi dhe shëndeti**
4	1.	Licencë	Prodhimi dhe/ose tregtimi i ushqimeve
5	2.	Licencë	Shërbime të riprodhimit, krijimit të racave ose veterinare
6	3.	Licencë	Rritja ose tregtimi i kafshëve
7	4.	Licencë	Prodhimi dhe/ose tregtimi i farërave dhe/ose i fidanëve
8	5.	Licencë	Prodhimi dhe/ose tregtimi i produkteve të mbrojtjes së bimëve, plehrave kimike dhe/ose produkteve prej duhaneve
9	6.	Licencë	Shërbime mjekësore parësore, spitalore ose të stomatologjisë
10	7.	Licencë	Prodhimi dhe/ose tregtimi i barnave për njerëz ose kafshë
11	8.	Licencë	Shërbime të tjera shëndetësore dhe/ose higjieno-sanitare
12	9.	Licencë	Prodhimi dhe/ose tregtimi i pajisjeve mjekësore
	Fusha III		**Mjedisi dhe burime mjedisore bazë**
13	1.	Leje	Për ndikimin në mjedis
14	2.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis
15	3.	Licencë	Importi i mbetjeve, për qëllim riciklimi, përpunimi dhe/ose përdorimi ose importi i substancave ozonholluese

16	4.	Leje	Shfrytëzimi dhe/ose kultivimi i florës (tokësore dhe/ose ujore)
16	5.	Leje	Shfrytëzimi dhe/ose mbarështimi i faunës (tokësore ose ujore)
17	6.	Leje	Shfrytëzimi i ujërave mbi dhe/ose nëntokësore dhe/ose baseneve e materialeve të tyre
18.	7.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet mjedisore bazë
	Fusha IV		**Burime minerare, hidrokarbure dhe energjetike**
20	1.	Leje	Minerare ose hidrokarbure
21	2.	Leje	Për të gjitha rastet që burojnë nga legjislacioni për koncesionet
22	3.	Leje	Rastet dhe llojet e tjera të përdorimit të burimeve me natyrë energjetike.
23.	4.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me burimet e kësaj fushe.
	Fusha V		**Territori dhe ndërtimi**
24	1.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me zhvillim e territorit dhe/ose ndërtimin
25	2.	Leje	Zhvillimi territorial dhe/ose ndërtimor
	Fusha VI		**Trashëgimia kulturore**
26	1.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me trashëgiminë kulturore
27	3.	Leje	Restaurim dhe/ose rrjetëzimi i monumenteve të trashëgimisë kulturore
28	4.	Licencë	Administrimi kolektiv i të drejtave të autorit
	Fusha VII		**Transporti**
29	1.	Licencë	Transport rrugor ndërkombëtar i udhëtarëve
30	2.	Licencë	Transport rrugor ndërkombëtar mallrash për të tretë
31	3.	Licencë	Shërbime ekspertize dhe/ose profesionale të lidhura me transportin rrugor
32	4.	Licencë	Transport ndërkombëtar detar i automjeteve dhe/ose i udhëtarëve
33	5.	Licencë	Për shërbime portuale
34	6.	Licencë	Për shërbime hekurudhore
35	7.	Licencë	Për shërbime aeroportuale
	Fusha VIII		**Industri dhe shërbime të tjera**
36	1.	Licencë	Prodhimi, depozitimi, transporti, përdorimi dhe/ose tregtimi i produkteve dhe/ose i lëndëve a pajisjeve të tjera me rrezikshmëri
	Fusha IX		**Arsimi dhe shkenca**
37	1.	Licencë	Arsimi parauniversitar
38	2.	Licencë	Arsimi i lartë
	Fusha X		**Kujdesi shoqëror dhe punësimi**
39	1.	Licencë	Shërbime të kujdesit shoqëror
40	2.	Licencë	Shërbime të ndërmjetësimit në tregun e punës dhe/ose të formimit profesional
	Fusha XI		**Drejtësia dhe ligji**
41	1.	Licencë	Shërbimi i noterisë
42	2.	Licencë	Shërbimi i përmbarimit
43	3.	Licencë	Shërbime të tjera ekspertize ose profesionale të lidhura me të drejtat civile dhe/ose penale

	Fusha XII		**Financat publike**
44	1.	Licencë	Për trajtime të favorizuara fiskale dhe/ose doganore
45	2.	Licencë	Shërbime ekspertize ose profesionale financiare apo shërbime të lidhura me financat publike
46	3.	Licencë	Organizimi i lojërave të fatit
47	**Fusha XIII**		**Turizmi**
	1.	Licencë	Agjenci udhëtimi dhe/ose operator turistik

VENDIM
Nr. 30/2021

PËR RRËZIMIN E DEKRETIT NR. 11 981, DATË 26.2.2021, "PËR KTHIMIN E LIGJIT NR. 15/2021, 'PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 59/2014, 'PËR KARRIERËN USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 85, pika 2, të Kushtetutës dhe nenit 86 të Rregullores së Kuvendit,

KUVEND I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Rrëzimin e dekretit nr. 11 981, datë 26.2.2021, "Për kthimin e ligjit nr. 15/2021, 'Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 59/2014, 'Për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar".

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Gramoz Ruçi

Miratuar në datën 16.3.2021.

DEKRET
Nr. 12023, datë 17.3.2021

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe të nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, këtyre personave:

1. Ridvan Misin Hoxha
2. Valdrin Teki Shehu
3. Vlora Adem Polia (Maxharri)
4. Adriatik Shaban Zhara
5. Zümre Yalçin Özlen
6. Marco Angelo Montanaro
7. Kemail Fehmi Musa
8. Minire Naim Kukaj (Mustafa)
9. Bahrije Ramiz Cara (Hamiti)
10. Ramis Ergün Ali Nafi Paksoy
11. Alfred Hil Marniku
12. Fatime Tahir Jerlija Sopi (Jerlija)
13. Ditlind Sami Ulaj
14. Resul Ahmet Kiliç
15. Mustafa Ali Gezen
16. Selime Ahmet Pupli (Ipekişen)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 12025, datë 18.3.2021

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika "c", dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13 e 20, të ligjit nr. 113/2020, "Për shtetësinë", me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Egin Neritan Ceka
2. Rida Egin Zeka

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 12030, datë 19.3.2021

PËR EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 93 dhe të nenit 136 të Kushtetutës; të nenit 48, pika 11, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, pas administrimit pranë Institucionit të Presidentit të Republikës në datën 17.3.2021, të propozimit të arsyetuar të përcjellë, me shkresën me nr. 1135/13 prot., datë 16.3.2021, dhe të vendimit nr. 88, datë 12.3.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatit z. Sokol Binaj", shoqëruar me praktikën dokumentare të ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 241, datë 9.7.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendosa të:

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Sokol Binaj emërohet gjyqtar i Gjykatës së Lartë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 12031, datë 19.3.2021

PËR EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 93 dhe të nenit 136 të Kushtetutës; të nenit 48, pika 11, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, pas administrimit pranë Institucionit të Presidentit të Republikës në datën 17.3.2021, të propozimit të arsyetuar të përcjellë, me shkresën me nr. 1135/14 prot., datë 16.3.2021, dhe të vendimit nr. 89, datë 12.3.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatit znj. Albana Boksi", shoqëruar me praktikën dokumentare të ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 242, datë 9.7.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendosa të:

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Albana Boksi emërohet gjyqtar i Gjykatës së Lartë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 12032, datë 19.3.2021

PËR EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 93 dhe të nenit 136 të Kushtetutës; të nenit 48, pika 11, të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, pas administrimit pranë Institucionit të Presidentit të Republikës në datën 17.3.2021, të propozimit të arsyetuar të përcjellë, me shkresën me nr. 1135/16 prot., datë 16.3.2021, dhe të vendimit nr. 90, datë 12.3.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatit z. Sandër Simoni", shoqëruar me praktikën dokumentare të ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 243, datë 9.7.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendosa të:

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Sandër Simoni emërohet gjyqtar i Gjykatës së Lartë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET
Nr. 12033, datë 19.3.2021

PËR EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 93 dhe të nenit 136 të Kushtetutës; të nenit 48, pika 11, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, pas administrimit pranë Institucionit të Presidentit të Republikës në datën 17.3.2021, të propozimit të arsyetuar të përcjellë, me shkresën me nr. 1135/16 prot., datë 16.3.2021, dhe të vendimit nr. 91, datë 12.3.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, "Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatit z. Klodian Kurushi", shoqëruar me praktikën dokumentare të ngritjes në detyrë për në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, për pozicionin e lirë në fushën e së drejtës penale, të shpallur me vendimin nr. 244, datë 9.7.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, vendosa të:

DEKRETOJ:

Neni 1

Zoti Klodian Kurushi emërohet gjyqtar i Gjykatës së Lartë.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

AKT NORMATIV
Nr. 9, datë 22.3.2021

PËR MIRATIMIN E TEKSTIT TË MARRËVESHJES NDËRMJET MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK DHE DISTRIBUTORIT TË AUTORIZUAR *"KEYMEN ILAÇ SANAYI VE TICARET" A.Ş.* PËR FURNIZIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME VAKSINËN E INAKTIVIZUAR KUNDËR COVID-19 *(VERO CELL) CORONAVAC*, TË KRIJUAR NGA *SINOVAC LIFE SCIENCE CO LTD.* DHE TË PRODHUAR NË REPUBLIKËN POPULLORE TË KINËS

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Neni 1
Miratimi i tekstit të marrëveshjes

1. Miratimin e tekstit të marrëveshjes ndërmjet, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe distributorit të autorizuar *"Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret" A.Ş.*, për furnizimin e Republikës së Shqipërisë me vaksinën e inaktivizuar kundër COVID-19 *(Vero Cell) Coronavac*, të krijuar nga *Sinovac Life Science Co Ltd.* dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij akti normativ.

2. Marrëveshja për furnizimin ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik dhe *"Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret" A.Ş.*, për shkak të sekretit tregtar dhe kërkesës së shprehur në marrëveshje nga *"Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret",* nuk do të publikohet në asnjë *website* të institucioneve apo në Fletoren Zyrtare.

3. Të gjitha institucionet e përfshira në dhënien e mendimit, të miratimit apo që janë pjesë e procesit kanë detyrimin të mos bëjnë publike marrëveshjen bashkëlidhur këtij akti normativ apo pjesë të saj.

4. Detyrimet e organeve shtetërore dhe përjashtimet nga detyrimet për furnizimin e vaksinës anticovid, të përcaktuara në aktin normativ nr. 1, datë 10.1.2021, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, janë të njëjta edhe për furnizimin e vaksinës së inaktivizuar kundër COVID-19 *(Vero Cell), Coronavac* të krijuar nga *Sinovac Life Science Co Ltd.* dhe të prodhuar në Republikën Popullore të Kinës, të furnizuar për Shqipërinë nga *Keymen Ilaç Sanayi ve ticaret A.Ş.,* sipas kushteve të tekstit të marrëveshjes bashkëlidhur këtij akti normativ.

Neni 2
Efektet financiare

Efektet financiare, që rrjedhin nga marrëveshja bashkëlidhur këtij akti normativ, përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2021.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

URDHËR
Nr. 117, datë 5.3.2021

PËR MIRATIMIN E FORMËS DHE TË PËRMBAJTJES SË VULËS, DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT DHE TË PLUMBIT TË SEKUESTRIMIT PËRMBARIMOR TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar; të nenit 44, pika 5, të` ligjit nr. 26/2019, "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat",

URDHËROJ:

1. Miratimin e formës dhe të përmbajtjes së vulës të përmbaruesit gjyqësor privat, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

2. Miratimin e formës së dokumentit të identifikimit të përmbaruesit gjyqësor privat, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

3. Miratimin e formës së plumbit të sekuestrimit përmbarimor të përmbaruesit gjyqësor privat, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.

4. Dokumenti i identifikimit përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj dhe paraqitet në çdo rast të ushtrimit të detyrës nga përmbaruesi gjyqësor privat. Përmbaruesi gjyqësor privat nuk mund të kryejë veprime procedurale pa qenë i pajisur me dokumentin identifikues.

5. Plumbi i sekuestrimit përmbarimor vendoset nga përmbaruesi gjyqësor privat vetëm në sendet e

luajtshme apo të paluajtshme, të cilat i sekuestron apo për të cilat kryen një veprim përmbarimor.

6. Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, me kërkesë të përmbaruesve gjyqësorë privatë, porosit dhe shpërndan dokumentin e identifikimit dhe plumbin e sekuestrimit përmbarimor.

7. Tarifa për pajisjen me dokumentin e identifikimit dhe plumbin e sekuestrimit përmbarimor, që mbulon koston e prodhimit të tyre, caktohet nga Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, sipas rregullave të organizimit të brendshëm të kësaj dhome.

8. Përmbaruesi gjyqësor privat i pezulluar, dorëzon dokumentin e identifikimit dhe plumbin e sekuestrimit përmbarimor pranë Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë, brenda pesë ditëve nga marrja e njoftimit të urdhrit përkatës.

9. Dokumenti i identifikimit dhe plumbi i sekuestrimit arkivohen në dosjen personale të përmbaruesit me shënimin përkatës dhe i kthehet përmbaruesit vetëm më riaktivizimin e veprimtarisë përmbarimore, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Procesi i dorëzimit, arkivimit apo përkatësisht rikthimit pasqyrohet në procesverbalin përkatës që mbahet nga strukturat përgjegjëse për monitorimin e veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor privat në Ministrisë e Drejtësisë.

11. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore e Çështjeve të Drejtësisë, përmbaruesit gjyqësorë privatë dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësor Privatë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

12. Ngarkohet sektori i Arkiv-Protokollit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

SHTOJCË NR. 1
FORMA DHE PËRMBAJTJA E VULËS SË PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT

Vula e përmbaruesit gjyqësor privat ka formë rrethore dhe diametër 33 centimetra. Në qendër vendoset stema dhe rreth saj shkruhet "Republika e Shqipërisë", në vijim shënimi: "Përmbarues gjyqësor privat", emri, shkronja e parë e emrit të babait, mbiemri i përmbaruesit.

SHTOJCË NR. 2
FORMA E DOKUMENTIT TË IDENTIFIKIMIT TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT

Dokumenti i identifikimit të përmbaruesit ka formë drejtkëndëshe, me përmasa 8.5 cm x 5.5 cm. Me sfond të bardhë e germa të zeza.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË

ZYRA E PËRMBARIMIT PRIVAT (*EMËRTIMI I SUBJEKTIT*)
(*EMËR MBIEMËR)*

PËRMBARUES GJYQËSOR PRIVAT

- Shërbimi Përmbarimor në Republikën e Shqipërisë organizohet në Shërbim Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror dhe në Shërbim Përmbarimor Gjyqësor Privat.
- Organet shtetërore ose publike janë të detyruara të ndihmojnë përmbaruesit gjyqësorë në ushtrimin e funksioneve, sipas ligjit, sa herë kërkohet ndihma e tyre.
- Ky dokument përdoret vetëm gjatë ushtrimit të detyrës ose për shkak të saj.

MINISTRIA E DREJTËSISË
Emër, mbiemër, nr. licence X, NUIS Y0203040508Q
Adresa:_____

SHTOJCË NR. 3
FORMA E PLUMBIT TË SEKUESTRIMIT PËRMBARIMOR TË PËRMBARUESIT GJYQËSOR PRIVAT

Kjo formë dhe model i plumbit të sekuestrimit përmbarimor me përmasa 90 mm x 44 mm, miratohet nga Ministria e Drejtësisë dhe prodhohet në numër të autorizuar nga subjekte shtetërore ose private, sipas kërkesave të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë.



URDHËR
Nr. 118, datë 5.3.2021

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË QENDRËS KOMBËTARE TË TRAJNIMIT TË PËRMBARUESVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar, të nenit 17, pika 5, të ligjit nr. 26/2019, "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat",

URDHËROJ:

1. Miratimin e "Rregullores së Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbaruesve", sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Trajnimit të Përmbaruesve dhe Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

RREGULLORE
PËR QENDRËN KOMBËTARE TË TRAJNIMIT TË PËRMBARUESVE

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave të hollësishme mbi mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbaruesve, mënyrën e financimit, si dhe përzgjedhjen dhe veprimtarinë e stafit akademik.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) "Qendra Kombëtare e Trajnimit të Përmbaruesve", në vijim "Qendra" ngrihet pranë Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë, në vijim "Dhoma", si dhe është përgjegjëse për trajnimin fillestar dhe vazhdues të përmbaruesve gjyqësorë privatë.

b) "Aktivitete të Qendrës" përfshin të gjitha aktivitetet që ofrohen dhe zhvillohen nga Qendra për kandidatët përmbarues, ndihmëspërmbaruesit

dhe përmbaruesit gjyqësorë privatë, të cilët kanë për qëllim trajnimin fillestar dhe vazhdues dhe zhvillohen në funksion të përmirësimit të kualifikimit profesional të pjesëmarrësve, si dhe kurset e trajnimit për juristë, që synojnë njohuri profesionale, teorike dhe praktike në fushën e ekzekutimit të detyruar përmbarimor, si dhe për të interesuarit e tjerë lidhur me këtë fushë.

c) "Formimi fillestar" është programi i detyrueshëm i trajnimit fillestar 1-vjeçar të organizuar nga Qendra për kandidatët përmbarues.

ç) "Formimi vazhdues" është programi i detyrueshëm i trajnimit vazhdues për ndihmëspërmbaruesit dhe përmbaruesit, i cili bazohet në trajnimet e formimit vazhdues profesional të organizuar nga Qendra, brenda të cilave përmbaruesi/ndihmëspërmbaruesi plotëson numrin e caktuar të ditëve të trajnimit, bazuar në procedurat, kriteret dhe standardet e parashikuara në ligjin për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat, kjo Rregullore dhe akte të tjera nënligjore.

d) "Certifikatë" është dëshmia e lëshuar nga Këshilli Drejtues për përfundimin me sukses të trajnimit fillestar dhe vazhdues, si dhe nga Qendra për përfundimin me sukses të trajnimeve informuese dhe të kurseve të trajnimit nga juristët të kursit të trajnimit për përfitimin e njohurive profesionale, teorike dhe praktike në fushën e ekzekutimit të detyruar.

Neni 3
Objektivat e Qendrës

Qendra synon përmbushjen e objektivave të mëposhtëm:

a) marrjen e masave për formimin fillestar të kandidatëve përmbarues dhe formimin vazhdues të ndihmëspërmbaruesve dhe të përmbaruesve gjyqësorë privatë;

b) ofrimin e kualifikimit profesional për ndihmëpërmbaruesit/përmbaruesit gjyqësorë privatë, nëpërmjet zhvillimit të një programi trajnimi të përshtatshëm vazhdues, me qëllim përmirësimin e shërbimit, zhvillimin profesional të pjesëmarrësve në procedurat përmbarimore, nxitjen e aftësive të komunikimit dhe të bashkëpunimit me palët gjatë procedurës përmbarimore, si dhe në komunikimin me personat e tretë;

c) botimin e materialeve apo të revistave në fushën e ekzekutimit të detyrueshëm;

ç) organizimin e konferencave kombëtare apo ndërkombëtare, në bashkëpunim me institucione të huaja, në fushën e ligjit dhe veçanërisht ekzekutimit të detyrueshëm;

d) realizimin e trajnimeve informuese për të interesuarit në fushën e ekzekutimit të detyrueshëm;

dh) ofrimi i mundësisë për përfituesit, që duke u angazhuar në punë në grup të kryejnë kërkime për zhvillimin e tyre profesional dhe kërkime në kontribut të zhvillimit të përgjithshëm të sistemit përmbarimor;

e) mundësimin e shëndoshjes së dijeve të publikut dhe të profesionistëve të tjerë ligjorë mbi fushën dhe veprimtarinë e përmbarimit;

ë) nxitjen e frymës së bashkëpunimit profesional ndërmjet anëtarëve të Dhomës, përmes trajnimeve përkatëse;

f) informimin e anëtarëve të Dhomës për të gjitha aktivitetet e Qendrës.

Neni 4
Aktivitetet e Qendrës

1. Qendra e Trajnimit ofron tri lloje të programeve të trajnimit:

a) programin e detyrueshëm për trajnimin fillestar për kandidatët përmbarues;

b) programin e detyrueshëm për trajnimin vazhdues për ndihmëspërmbaruesit dhe përmbaruesit gjyqësor;

c) kurse trajnimi për juristë që synojnë njohuri profesionale, teorike dhe praktike në fushën e ekzekutimit të detyruar përmbarimor.

2. Qendra, gjithashtu, ofron:

a) trajnime informuese në fushën e ekzekutimit të detyrueshëm;

b) botimin e materialeve apo të revistave në fushën e ekzekutimit të detyrueshëm;

c) organizimin e konferencave kombëtare apo ndërkombëtare në bashkëpunim me institucione të huaja, në fushën e ligjit dhe veçanërisht ekzekutimit të detyrueshëm.

3. Trajnimet, si dhe çdo aktivitet tjetër i organizuar nga Qendra, publikohet në faqen zyrtare të Dhomës dhe Qendrës.

4. Qendra mund të zhvillojë aktivitetet e mësipërme dhe në bashkëpunim me institucionet

publike ose private që operojnë brenda dhe jashtë vendit në fushën e ekzekutimit të detyrueshëm dhe/ose edukimit profesional.

5. Dhoma mund të lidhë marrëveshje bashkëpunimi me organet drejtuese të dhomave të tjera të profesioneve të lira dhe/ose me institucione të tjera të interesuara, lidhur me organizimin e programeve të përbashkëta të trajnimeve ose për trajnime specifike.

Neni 5
Logoja e Qendrës

Qendra ka logon e saj me mbishkrimin në shqip dhe në anglisht: "QENDRA KOMBËTARE E TRAJNIMIT TË PËRMBARUESVE", me germa të zeza, me simbolin e Dhomës. Sfondi i logos është në ngjyrë të bardhë.

Neni 6
Vula e Qendrës

1. Qendra ka vulën e saj.

2. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Vula përdoret nga drejtori ekzekutiv i Qendrës, në rastet e lëshimit të certifikatave të përfundimit me sukses të trajnimeve informuese dhe kurseve të trajnimit.

4. Vula përdoret dhe në rastet e komunikimit zyrtar të Qendrës.

KREU II
ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS

Neni 7
Statusi i Qendrës

1. Qendra organizohet dhe funksionon pranë Dhomës.

2. Qendra është institucioni përgjegjës për trajnimin fillestar dhe vazhdues të përmbaruesve gjyqësorë private dhe zhvillimin e kapaciteteve profesionale të tyre.

3. Qendra financohet dhe administrohet nga Dhoma.

4. Qendra ka numrin e saj të llogarisë bankare.

5. Qendra ka adresën e saj zyrtare elektronike.

Neni 8
Drejtori Ekzekutiv i Qendrës

1. Qendra e Trajnimit administrohet nga drejtori ekzekutiv, i zgjedhur për një mandat 4-vjeçar nga Këshilli Drejtues i Dhomës me propozimin e kryetarit të Dhomës.

2. Drejtori ekzekutiv i Qendrës trajtohet financiarisht, sipas rregullave në fuqi dhe standardeve që aplikohen për struktura të tilla të ngjashme. Pagesa e tij përcaktohet me vendim të Këshillit Drejtues të Dhomës dhe është pjesë e buxhetit të Dhomës.

Neni 9
Kriteret për zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës

Kriteret për zgjedhjen e Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës, janë si më poshtë:

a) të ketë jo më pak se 10 (dhjetë) vjet përvojë profesionale në fushën e së drejtës;

b) të gëzojë integritet të lartë profesional dhe moral;

c) të mos jetë shkarkuar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

ç) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit në kuptimin e legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë;

dh) të zotërojë tituj ose grada shkencore, ose të ketë eksperiencë të provuar shkencore.

Neni 10
Kompetencat e drejtorit ekzekutiv të Qendrës

Drejtori ekzekutiv i Qendrës ka kompetencat e mëposhtme:

a) raporton përpara Këshillit Drejtues të Dhomës për ecurinë e veprimtarisë së Qendrës;

b) harton, përditëson dhe publikon kalendarin e veprimtarive në faqen zyrtare të Qendrës dhe të Dhomës;

c) informon Asamblenë e Përgjithshme mbi veprimtarinë e Qendrës, të paktën një herë në vit;

ç) informon kryetarin e Dhomës, në fund të çdo viti kalendarik, për numrin e krediteve (ditëve të trajnimit) të fituara/kryera nga çdo përmbarues/ ndihmëspërmbarues;

d) planifikon ngarkesën mësimore vjetore për stafin akademik që do të angazhohet në realizimin e programit të detyrueshëm të trajnimit fillestar 1-vjeçar;

dh) propozon stafin akademik të Qendrës dhe trajnerët për trajnimet vazhduese dhe aktivitetet e tjera trajnuese, të cilat i paraqet për vlerësim dhe miratim pranë Këshillit Drejtues;

e) propozon numrin e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të Qendrës;

ë) lëshon certifikatën e përfundimit me sukses të çdo programi të trajnimeve informuese, kurseve të trajnimit, konference, të organizuar nga Qendra ose nga Qendra në bashkëpunim me institucione të tjera partnere, në përfundim të tyre;

f) përcakton hapat që duhen ndjekur, në lidhje me rritjen e kapaciteteve cilësore të veprimtarisë akademike dhe administrative të Qendrës, përmes pyetësorëve dhe anketimeve për vlerësimin e stafit akademik dhe trajnuesve;

g) merr vendime për çështje që janë brenda fushës së kompetencave të tij.

Neni 11
Veprimtaria administrative dhe akademike e Qendrës

Veprimtaria administrative dhe akademike e Qendrës përfshin:

a) hartimin, përditësimin dhe publikimin e kalendarit të veprimtarive të Qendrës në faqen zyrtare të Qendrës dhe të Dhomës;

b) organizimin e trajnimit të detyrueshëm për formimin fillestar, sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin për shërbimin përmbarimor privat dhe në programin e detyrueshëm për trajnimin fillestar;

c) organizimin e trajnimeve të detyrueshme për realizimin e programit të trajnimit vazhdues, sipas përcaktimeve të parashikuara në ligjin për shërbimin përmbarimor privat dhe në programin e detyrueshëm për trajnimin vazhdues;

ç) organizimin e kurseve të trajnimit për juristët, që synojnë njohuri profesionale, teorike dhe praktike në fushën e ekzekutimit të detyruar përmbarimor;

d) krijimin dhe administrimin e regjistrit të të dhënave për programin e trajnimit fillestar dhe regjistrit për programin e trajnimit vazhdues;

dh) kryerjen e studimeve kërkimore shkencore në funksion të përmirësimit të veprimtarive të saj;

e) bashkëpunimin ndërinstitucional për hartimin dhe zbatimin e kurrikulave, kritereve dhe standardeve, në lidhje me programin e trajnimit fillestar dhe vazhdues me aktorë, partnerë, bashkëpunëtorë të rëndësishëm në fushën e edukimit dhe formimit profesional;

ë) bashkëpunimin me institucione brenda dhe jashtë vendit për mbështetje akademike dhe shkencore;

f) bashkëpunimin me institucione brenda dhe jashtë vendit për certifikime kombëtare dhe ndërkombëtare në fushën e formimit profesional.

KREU III
STAFI AKADEMIK DHE TRAJNERËT E QENDRËS

Neni 12
Stafi akademik dhe administrativ i Qendrës

1. Stafi akademik i Qendrës përbëhet nga stafi i brendshëm dhe nga stafi i jashtëm.

2. Stafi akademik i brendshëm ka detyrimin e realizimit të një ngarkesë mësimore vjetore në auditor të përcaktuar në kontratën e punës. Ky staf mund të angazhohet edhe në programin e detyrueshëm të trajnimit vazhdues ose në kurset e trajnimit.

3. Stafi akademik i jashtëm realizon një ngarkesë akademike në auditor të përcaktuar në kontratën përkatëse. Ky staf mund të angazhohet edhe në programin e detyrueshëm të trajnimit vazhdues ose në kurset e trajnimit.

4. Stafi administrativ emërohet në bazë të nevojave të Qendrës dhe angazhohet në të gjitha proceset e realizimit të veprimtarive të saj.

5. Stafi akademik dhe administrativ i Qendrës emërohet nga Këshilli Drejtues i Dhomës. Drejtori ekzekutiv i Qendrës propozon stafin akademik dhe trajnerët për trajnimet vazhduese dhe aktivitetet e tjera trajnuese.

6. Tarifat e pagesës për stafin akademik propozohen nga drejtori ekzekutiv i Qendrës dhe miratohen nga Këshilli Drejtues i Dhomës.

Neni 13
Kriteret për zgjedhjen e stafit akademik

Stafi akademik që angazhohet në procesin e mësimdhënies në programin e detyrueshëm të trajnimit fillestar duhet të përmbushë kriteret e mëposhtme:

a) të ketë përfunduar ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë "Master i shkencave" ose diplomë të njësuar me të, ose studimet universitare për drejtësi jashtë shtetit, të njësuara në përputhje me rregullat për njësimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi;

b) të zotërojë kualifikimin profesional të nevojshëm, në përputhje me lëndën/modulin apo kurrikulën për të cilën do të angazhohet si pedagog;

c) të ketë jo më pak se 10 vjet përvojë pune si jurist apo në fushën e mësimdhënies;

ç) të ketë aftësi të prezantimit dhe të transmetimit të saktë dhe të qartë të informacionit te pjesëmarrësit;

d) të ketë integritet moral dhe reputacion të mirë në detyrën e tyre;

dh) të ketë aftësitë e nevojshme për të vlerësuar nevojat për formim profesional;

e) zotërimi i titujve ose i gradave shkencore përbën përparësi;

ë) të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze; përbën avantazh në përzgjedhje zotërimi edhe i gjuhëve të tjera të huaja;

f) aftësi të larta në komunikim;

g) veprimtaria shkencore në formën e botimeve dhe të konferencave.

Neni 14
Trajnerët që angazhohen pranë Qendrës

1. Në programin e trajnimit fillestar, vazhdues, si dhe në aktivitete të tjera të organizuara nga Qendra, angazhohen trajnerë.

2. Lista e trajnerëve dhe dokumentacioni përkatës, pasi shqyrtohet nga drejtori ekzekutiv i Qendrës, me propozim të këtij të fundit i paraqitet për miratim Këshillit Drejtues të Dhomës në fillim të çdo viti kalendarik.

3. Për përcaktimin e listës së trajnerëve, Qendra fton publikisht për aplikim të gjithë personat që mendojnë se kanë ekspertizë personale në një nga fushat dhe temat e programit të trajnimit vazhdues. Qendra, në varësi të temës së trajnimit do të hulumtojë për gjetjen e trajnerëve më të përshtatshëm dhe mund t'i drejtohet listës së të dhënave mbi trajnerët gjatë trajnimeve të organizuara më parë, bazës së të dhënave të partnerëve të huaj apo OJF-ve të ndryshme me të cilat Dhoma ka marrëdhënie apo çdo institucioni tjetër që posedon të dhëna të vlefshme që i shërbejnë veprimtarisë së Qendrës.

4. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

a) eksperiencë mbi 5-vjeçare si juristë; dhe

b) eksperiencë mësimdhënie akademike mbi 2 vjet; ose

c) eksperiencë mbi 5-vjeçare si përmbarues; dhe

ç) eksperiencë mësimdhënie akademike mbi 2 vjet; ose

d) përvojë profesionale e specifikuar në fushën/kursin/temën për të cilën do të jenë trajnues.

5. Kritere shtesë të rëndësishme për përzgjedhjen e të gjithë trajnerëve, të cilët duhet të konkurrojnë në mënyrë kumulative me kriteret e mësipërme, janë:

a) integriteti moral dhe reputacioni i mirë në detyrën e tyre, i cili ka të bëjë me respektimin e vazhdueshëm të rregullave në detyrën e tij/saj;

b) aftësi të larta në komunikim;

c) aktiviteti shkencor në formën e botimeve dhe të konferencave;

ç) të ketë aftësitë e nevojshme për të vlerësuar nevojat për trajnimin profesional të përmbaruesve/ndihmëspërmbaruesve;

d) të kenë njohuri të mira të gjuhës angleze; përbën avantazh në përzgjedhje zotërimi edhe i gjuhëve të huaja të tjera;

dh) aftësi të prezantimit dhe të transmetimit të saktë dhe të qartë të informacionit te pjesëmarrësit.

6. Aplikimi bëhet duke paraqitur dokumentacionin e nevojshëm që vërteton përmbushjen e kritereve të mësipërme, të shoqëruar nga një:

a) kërkesë zyrtare në format fizik apo elektronik;

b) një kopje të jetëshkrimit, duke specifikuar eksperiencën dhe trajnimet e marra, pjesëmarrjen në konferenca apo botime, të vërtetuar me dokumentet përkatëse;

c) titullin e temës, çështjes apo nënçështjes për të cilën kërkojnë të japin ekspertizën e tyre;

ç) metodologjinë që do të përdorin në trajnim;

d) projektprogramin e detajuar, sipas nenit 17 të kësaj rregulloreje.

7. Për zhvillimin e trajnimeve vazhduese, Dhoma nënshkruan me trajnerët kontratë shërbimi, në të cilat përcaktohen të drejtat e detyrimet reciproke.

8. Kontratat mund të jenë me objekt:

a) kontratë për formimin vazhdues profesional;

b) kontratë për hartimin e kurrikulave, materialeve trajnuese, si dhe materialeve të tjera didaktike në funksion të qëllimit dhe objektivave të Qendrës;

c) kontratë mësimdhënie etj.

9. Në sesionet e trajnimit mund të përdoren edhe lehtësues për të mbështetur punën e trajnuesve, me qëllim nxjerrjen e literaturës apo seleksionimin e rasteve të praktikës gjyqësore të nevojshme për trajnim.

10. Dhoma në bashkëpunim me Qendrën përcakton listën e lehtësuesve për çdo sesion trajnues. Lista hartohet mbi bazën e aplikimeve nga radhët e përmbaruesve gjyqësorë, të spikatur në pjesëmarrjen aktive të sesioneve trajnuese dhe me aftësi studimore. Detyrat e lehtësuesve përcaktohen në marrëveshje midis tyre dhe Dhomës.

11. Tarifa e pagesës për trajnerët propozohet nga drejtori ekzekutiv i Qendrës dhe miratohet nga Këshilli Drejtues i Dhomës.

Neni 15
Vlerësimi i punës së trajnerëve

1. Trajnerët që angazhohen pranë Qendrës i nënshtrohen një procesi vlerësimi, me qëllim monitorimin e punës së tyre dhe garantimin e cilësisë së mësimdhënies për pjesëmarrësit.

2. Procesi i vlerësimit të trajnerëve realizohet në fund të çdo viti kalendarik apo sesioni aktivitetesh dhe kryhet paralelisht nga analiza e disa komponentëve:

a) Vlerësimi nga pjesëmarrësit në trajnime bëhet në fund të vitit akademik apo kur mbaron grupi i sesioneve/seminareve me anë të pyetësorëve, me shkrim, të përgatitur nga drejtori ekzekutiv i Qendrës. Marrja e informacionit përmes pyetësorëve bëhet në fund të vitit/aktiviteteve, duke respektuar anonimatin e pjesëmarrësve. Pyetësorët e plotësuar grumbullohen nga sekretaria përgjegjëse për formimin vazhdues, përpunohen dhe i dorëzohen drejtorit ekzekutiv të Qendrës.

b) Vlerësimi nga drejtori ekzekutiv i Qendrës: Drejtori ekzekutiv i Qendrës, çdo fillim viti kalendarik, përgatit një raport mbi rezultatet e vlerësimit të trajnerëve gjatë vitit pararendës, së bashku me propozimet për marrjen e masave për largimin apo ndryshimin e atyre që nuk plotësojnë kriteret, me qëllim që të realizojë vendimmarrjen e tij në formën e dhënies së vlerësimit përfundimtar.

Neni 16
Detyrimet e stafit akademik dhe të trajnerëve

1. Stafi akademik dhe trajnerët që angazhohen pranë Qendrës marrin përsipër përmbushjen e detyrimeve të mëposhtme:

a) ushtrimi i funksionit të tyre objektivisht dhe paanësisht, në përputhje me ligjin, këtë rregullore dhe aktet e tjera;

b) orientimi i trajnimit, duke u nisur nga natyra praktike e trajnimit fillestar/vazhdues;

c) respektimi i vendimeve të Qendrës;

ç) respektimi i orareve të aktiviteteve trajnuese dhe njoftimi i Qendrës për çdo pamundësi pjesëmarrjeje jo më vonë se një javë nga dita e mësimdhënies, me përjashtim të rasteve të paparashikueshme. Në një rast të tillë, duhet të vënë në dispozicion punën parapërgatitore;

d) në zbatimin e aktiviteteve të tyre nuk duhet të ndikohen nga ndonjë doktrinë politike. Ata nuk mund të përdorin aktivitetet e tyre pedagogjike për të shprehur bindjet e tyre politike;

dh) ushtrimi me kompetencë dhe korrektësi i detyrave profesionale;

e) mospërhapja ose mospërdorimi i informacionit që mësojnë gjatë punës së tyre për ndonjë qëllim tjetër nga ai që lidhet me përgjegjësitë e tyre akademike/trajnuese;

ë) çdo detyrë tjetër, sipas përcaktimeve në kontratën e punës.

Neni 17
Detyrimet specifike të trajnuesve

1. Trajnerët e formimit vazhdues duhet të plotësojnë detyrimet e mëposhtme:

a) të depozitojnë pranë Qendrës një projektprogram të detajuar në kopje fizike dhe elektronike, ku në mënyrë specifike të jepet një përshkrim i çështjeve të trajnimit ose i modulit për

të cilin është zgjedhur, literatura që do të përdoret duke përfshirë një listë sintetike bibliografie (të asaj ku janë mbështetur dhe të asaj që sugjerohet për studime të mëtejshme), si dhe bazën ligjore që pjesëmarrësit duhet të disponojnë gjatë trajnimit;

b) të mbajnë shënime gjatë aktivitetit trajnues, lidhur me: sugjerime dhe vërejtje të audiencës mbi tematikën aktuale dhe perspektive të trajnimit; sugjerime për modifikime e ndryshime në legjislacion të dala nga seancat "diskutime dhe debat"; pjesëmarrjen në trajnime; aftësinë e pjesëmarrësve për t'u përqendruar brenda tematikës së trajnimit;

c) të gjitha këto dhe të tjera që lidhen me trajnimin vazhdues do t'i paraqesin në një "relacion" pranë Qendrës, jo më vonë se 2 (dy) javë pas trajnimit.

Neni 18
Metodologjia e trajnimit

1. Për metodologjinë e trajnimit, trajnerët që angazhohen pranë Qendrës duhet:

a) të zhvillojnë një metodë interaktive trajnimi;

b) të bëjnë përpjekje për të ruajtur një ekuilibër mes trajtimit teorik dhe praktik të çështjeve që janë objekt diskutimi, ku prioritet të kenë aspektet praktike;

c) të kujdesen për ndërhyrje konstruktive, të shpërndara dhe jodominuese, duke i lënë hapësirë të bollshme diskutimeve nga pjesëmarrësit;

d) të kenë aftësinë për të kombinuar disa metoda të trajnimit (prezantimi verbal, prezantimi me shkrim, puna në grup, pyetjet, përdorimin e mjeteve audiovizive etj.);

e) të kenë aftësi për të prezantuar materialin pa ndonjë mbështetje dokumentare dhe për të përgatitur materialet burimore të nevojshme, mbështetjen e aspekteve teorike dhe praktike, për të vëzhguar nivelin e duhur të ndërveprimit dhe mbështetjen e metodave të trajnimit, qëllimit dhe tematikës së prezantimeve dhe për të qëndruar brenda kohës së përcaktuar për një prezantim;

f) të bashkëpunojnë me trajnerët e tjerë që janë të përfshirë në të njëjtin trajnim apo tematikë.

2. Dy javë përpara çdo trajnimi, grupi i trajnerëve thirret në Qendër për të diskutuar lidhur me mbarëvajtjen e trajnimeve, si dhe kontaktohet me ta elektronikisht lidhur me masat e ndërmarra për realizimin e veprimtarive trajnuese.

KREU IV
CERTIFIKATA

Neni 19
Certifikata

1. Në fund të programit të detyrueshëm për trajnimin fillestar dhe trajnimit vazhdues, pjesëmarrësit pajisen me certifikatën e përfundimit me sukses të trajnimit fillestar ose vazhdues, që lëshohet nga Këshilli Drejtues. Nuk pajisen me certifikatë pjesëmarrësit që mungojnë qoftë edhe një seancë të trajnimit vazhdues. Në këtë rast, me kërkesë të tyre, pjesëmarrësit mund të marrin vërtetim vetëm për kohën që kanë frekuentuar.

2. Drejtori ekzekutiv i Qendrës përcakton rregulla të posaçme për identifikimin dhe monitorimin e pjesëmarrësve në aktivitetet trajnuese të programit për trajnimin fillestar dhe vazhdues përpara lëshimit të certifikatës.

3. Drejtori ekzekutiv i Qendrës lëshon certifikatën e përfundimit me sukses të çdo programi të trajnimeve informuese, kurseve të trajnimit, konference, të organizuar nga Qendra ose nga Qendra në bashkëpunim me institucione të tjera partnere, në përfundim të tyre.

Neni 20
Formati i certifikatës

1. Certifikatat përkatëse përmbajnë këto elemente:

a) emrin;

b) mbiemrin;

c) datat e zhvillimit të programit (trajnimit/ kursit) përkatës;

ç) titullin e programit përkatës;

d) numrin e krediteve, në rastin e trajnimit fillestar dhe vazhdues;

dh) numrin e regjistrit;

e) nënshkrimin dhe vulën e organit përgjegjës për lëshimin e tyre.

2. Në certifikatë, krahas logos së Dhomës vendoset dhe logoja e Qendrës.

3. Certifikata, që Dhoma/Qendra lëshon në bashkëpunim me institucionet me të cilat ka lidhur marrëveshjen përkatëse të bashkëpunimit, përmban, përveç elementeve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, edhe logon e institucionit

partner, si dhe të dhënat e autoritetit që certifikon këtë trajnim të përbashkët.

KREU V
REGJISTRAT E QENDRËS

Neni 21
Regjistri

1. Dhoma krijon dhe administron regjistrin e të dhënave për trajnimin fillestar të kandidatëve përmbarues dhe regjistrin për trajnimin vazhdues të zëvendëspërmbaruesve dhe të përmbaruesve privatë, formati i të cilëve hartohet dhe miratohet nga Këshilli Drejtues i Dhomës, dhe i dërgon kopje të tij ministrit të Drejtësisë deri më 31 janar të vitit paraardhës.

2. Regjistrat përmbajnë të dhëna personale dhe profesionale për të gjithë personat që janë trajnuar nga Qendra. Të dhënat personale mbahen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Për të gjithë personat e trajnuar do të ketë një dosje individuale, në të cilën do të dokumentohen të dhënat përkatëse për pjesëmarrjen në aktivitetet trajnuese, të cilat do të administrohen nga Dhoma.

Neni 22
Raportimi i aktiviteteve të zhvilluara jashtë Qendrës

1. Përmbaruesi ose ndihmëspërmbaruesi, që kryen aktivitete të ndryshme të formimit vazhdues të lidhura me fushën e veprimtarisë përmbarimore jashtë Qendrës, informon këtë të fundit për regjistrimin e tyre në regjistrin përkatës.

2. Regjistrimi i këtyre aktiviteteve, për efekt të plotësimit të detyrimeve të përcaktuara në ligjin për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat dhe në Statut, bëhet brenda vitit kalendarik.

3. Qendra informon përmbaruesin për numrin e krediteve të fituara për aktivitetin përkatës, bazuar në ekuivalentimin e përcaktuar në programin e detyrueshëm të trajnimit vazhdues.

KREU VI
FINANCIMI I QENDRËS

Neni 23
Financimi

1. Qendra mbështetet financiarisht për funksionimin e saj administrativ dhe akademik nga tarifat për trajnimin fillestar dhe vazhdues, si dhe nga të ardhurat e krijuara prej trajnimeve informuese, kurseve të trajnimit, botimeve apo konferencave, si dhe nga Dhoma.

2. Qendra siguron financime për ushtrimin e veprimtarisë së saj, sipas pikës 2 të nenit 4, nga donacionet apo grandet e ofruara nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare ose nga subjekte të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar.

Neni 24
Fondet, të ardhurat dhe mënyra e përdorimit të tyre

1. Fondet që akordohen në pajtim me Statutin e Dhomës dhe përcaktimeve në këtë rregullore, nga donacionet apo grandet e ofruara nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare ose subjekte të tjera të lejuara nga legjislacioni shqiptar, përdoren për:

a) pagat dhe shpërblimet e stafit akademik dhe administrativ;

b) honorarët e trajnerëve;

c) aktivitetet dhe veprimtaritë e miratuara sipas kalendarit vjetor;

ç) shpenzime administrative;

d) kryerjen e studimeve në funksion të përmirësimit të veprimtarive të Qendrës;

dh) botime akademike dhe shkencore;

e) veprimtaritë informuese dhe akademike të organizuara në formën e simpoziumeve, konferencave, seminareve, *workshope*-ve etj.

2. Qendra realizon të ardhura nga tarifat e pjesëmarrësve në trajnimet dhe kurset e përcaktuara në këtë rregullore.

3. Tarifat për trajnimet dhe kurset të përcaktuara në pikën 2, të nenit 4, të kësaj rregulloreje, përcaktohen nga Këshilli Drejtues i Dhomës.

KREU VII
DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 25
Hyrja në fuqi

Rregullorja hyn në fuqi pas miratimit nga ministri i Drejtësisë.

URDHËR
Nr. 239, datë 19.3.2021

PËR DELEGIM KOMPETENCASH

Në mbështetje dhe në zbatim të nenit 11/b, të ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003, "Për arkivat"; të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, si dhe të nenit 11, pikave 2 dhe 3, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore",

URDHËROJ:

1. Z. Endri Musaj, drejtor i Inspektimit dhe Trajnimeve, i delegohet kompetenca e nënshkrimit të dokumenteve që njoftojnë institucionet fondkrijuese për dërgimin e inspektorit për asistencë, nëse plotësohet kushti që asistenca zhvillohet nga inspektori që është person kontakti i atij fondkrijuesi.
2. Kompetenca e deleguar do të ushtrohet deri në një urdhër të dytë.
3. Për zbatimin e urdhrit ngarkohet drejtori i Inspektimit dhe Trajnimeve z. Endrit Musaj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ardi Bido

NJOFTIM
Nr. 3396, datë 19.3.2021

MBI HYRJEN NË FUQI TË NJË PROTOKOLLI NDRYSHUES

"Protokolli ndryshues i marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për shmangien e tatimit të dyfishtë lidhur me tatimet mbi të ardhurat dhe mbi kapitalin dhe për parandalimin e evazionit fiskal", nënshkruar më 2.10.2020, ka hyrë në fuqi më 16 mars 2021.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM I
MINISTRISË PËR EVROPËN
DHE PUNËT E JASHTME
Armand Skapi

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 125 (13-2021-666), datë 1.2.2021, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Edmond Dinaku, i biri i Ferdinantit dhe i Liljanës, i datëlindjes 27.4.1964, me banim në Bashkinë Elbasan, duke përcaktuar si ditë të vdekjes së tij, datën 15.8.1995.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 1 (55), datë 19.1.2021, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar të shtetasit Herëmont Vasil Piho, i datëlindjes 18.8.1974, me nr. personal H40818019U, lindur dhe banues në fshatin Çermë Sektor, Lushnjë, si dhe caktimin e kërkuesit Mihal Vasil Piho, i datëlindjes 25.7.1965, me nr. personal G50725182M, banues në Kavajë, si kujdestar të tij.

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. 2 (173), datë 2.2.2021, vendosi heqjen e zotësisë për të vepruar për shtetasin Julian Topanxha, me atësi Nas dhe amësi Efigjeni, i datëlindjes 8.8.1980, lindur dhe banues në Divjakë, si dhe caktimin si kujdestar dhe përfaqësues ligjor të tij kërkuesen Griselda Topanxha.

KËRKESË

Shtetasja Iris Beluli kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë shpalljen e vdekjes së babait të saj, shtetasit Romeo Beluli, i biri i Myfitit dhe i Elmës, lindur më 18.3.1968, në Vlorë.

KËRKUESE
Iris Beluli

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2021 - Numri: 45
Datë: 2021/03/23 16:50:50
c74e3b36-35d7-431e-b4e8-f12f9db35814

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë